
JETA SHKENCORE

KONFERENCË SHKENCORE: “MARTANESHI – HISTORI E TRADITË” Tiranë, 13 dhjetor 2009

Qendra e Studimeve Albanologjike në bashkëpunim me Komunën e Martaneshit, si dhe Shoqatën Atdhetare-Kulturore “Martaneshi” në vazhden e aktiviteteve shkencore, organizuan më 13 dhjetor 2009, në Tirana International Konferencën Shkencore me temë: “Martaneshi – Histori e Traditë”.

Kjo konferencë u realizua në kuadër të 100-vjetorit të hapjes së shkollës së parë shqipe në Martanesh dhe në 50-vjetorin e minierës së kromit “11 Heronjtë”, Batër-Martanesh. Ky projekt u financua nga Komuna “11 Heronjtë” Martanesh dhe biznesmenë të minierës Batër. Moderator dhe organizator i Konferencës ishte Ma. Teki Kurti.

Në këtë tubim morën pjesë studiues dhe historianë nga Instituti i Historisë, Instituti i Antropologjisë, Instituti i Gjuhësisë si dhe Instituti i Minerave e Fakulteti i Historisë dhe Filologjisë. Morën pjesë gjithashtu përfaqësues të Klerit Bektashian, drejtues të Komunës dhe Shoqatës “Martaneshi” si dhe personalitete të fushave të arsimit e kulturës, e minierës së Batrës, studentë e përfaqësues të medias etj.

Konferencën e hapi Kryetari i Këshillit të Komunës Ma. Teki Kurti, i cili falënderoi Qendrën e Studimeve Albanologjike për angazhimin dinjitoz të saj me studiues e historianë nga më të mirët në vendin tonë për të referuar në këtë konferencë shkencore që i kushtohet trevës së Martaneshit.

Ai veçoi faktin që kjo konferencë shkencore realizohet në dy momente jubilarë shumë të rëndësishme si për zonën e Martaneshit ashtu dhe për gjithë vendin, pasi hapja e shkollës së parë shqipe në Martanesh 100 vjet më parë ishte kurorëzim i përpjekjeve të pashembullta të rilindësve nëpërmjet klubit “Bashkimi” në bashkëpunim të ngushtë me banorët patriotë e atdhetarë të Martaneshit si dhe me një mbështetje të veçantë të Babait të ndritur të Teqesë Bektashiane, Jashar Krenës. Kjo teqe u bë baza e parë e mbështetjes së shkollës së parë shqipe dhe nga kjo shkollë lindi çeta e parë e lirisë që në krah të çetave të tjera do të kontribuonte në pavarësinë e Shqipërisë.

Gjithashtu në fjalën e tij Ma. Teki Kurti theksoi se 50-vjetori i minierës së kromit “11 Heronjtë” Batër-Martanesh është një moment shumë i rëndësishëm si për zhvillimin ekonomik e social-kulturor të zonës ashtu dhe për kontributin e veçantë që ka dhënë në zhvillimin e tërë ekonomisë kombëtare.

Konferencën e përshëndeti në emër të banorëve të Martaneshit Kryetari i kësaj Komune, ing. Gazmend Kenga. Ai veçoi në fjalën e tij se kjo konferencë

do t'i shërbejë njohjes së vlerave historike kulturore dhe ekonomike të trevës së Martaneshit në një nivel të lartë shkencor dhe për këtë përgëzoi angazhimin e Qendrës së Studimeve Albanologjike si dhe gjithë studiuesit e tjerë kontribuues në këtë konferencë shkencore.

Në emër të shoqatës Atdhetare-Kulturore “Martaneshi” përshëndeti kryetari i saj Z. Skënder Gjoni. Ai vlerësoi dhe përshëndeti të gjithë stafin akademik që me punën e tyre kërkimore e shkencore për trevën e Martaneshit kontribuojnë që këto vlera jo vetëm të hulumtohen e njihen nga ana shkencore por edhe të promovohen si asnjë herë tjetër në një konferencë shkencore kombëtare ku padyshim çdo kumtesë e sotme do të jetë një temë e rëndësishme për nesër me qëllim që brezi i ri i Martaneshit dhe më gjerë të njohë mirë kontributin e të parëve të tij në të gjitha etapat e zhvillimit kombëtar.

Konferenca i vazhdoi punimet në dy seanca.

Seancën e parë e drejtuan: akademik Beqir Meta, prof. dr. Aleksandër Meksi, prof. dr. Shaban Sinani, ma. Teki Kurti dhe ing. Gazmend Kenga.

Në këtë seancë referuan: prof. dr. Gjovalin Gruda me kumtesën: *Veçoritë fiziko-gjeografike të Martaneshit*; prof. dr. Aleksandër Meksi me kumtesën: *Gjendja kishtare në Martanesh gjatë Mesjetës*; prof. dr. Pullumb Xhufi me kumtesën: *Cunavia dhe Martaneshi në epokën e Arbërit*. Kurse akademik Beqir Meta në bashkëpunim me ma. Sokol Gjermanin referoi kumtesën: *Martaneshi gjatë Rilindjes – vatër e arsimit, kulturës dhe luftës për lirie e pavarësi*.

Kujtim Ahmetaj nëpërmjet një dokumentari të shkurtër filmik realizoi dhe paraqiti temën: *Teqeja bektashiane e Martaneshit dhe kontributi i saj në lëvizjen kombëtare*; ma. Teki Kurti referoi kumtesën: *Martaneshi në dokumente dhe në vëzhgimin e autorëve të huaj*; prof. dr. Shaban Sinani referoi kumtesën: *Martaneshi në studimet e etnologes angleze M. Hasluck*; prof. dr. Afërdita Onuzi kumtesën me temë: *Vlera kulturore-historike të veshjeve popullore të Martaneshit*, të cilën e lexoi studentja e juridikut Milena Gjoni.

Konferenca i vazhdoi punimet me seancën e dytë, e cila u drejtua nga prof. dr. Muharrem Dezhgiu, dr. Spiro Gjoni, dr. Moikom Zeqo, ing. Tahir Osmani, ing. Shaban Zhaboli dhe ma. Arjeta Cuka.

Dr. Moikom Zeqo lexoi kumtesën: *Aspekte të Martaneshit në Antikitet*; prof. dr. Muharrem Dezhgiu mbajti kumtesën me temë: *Martaneshi dhe Baba Faja – binom historik gjatë Luftës së Dytë Botërore në Shqipëri*; prof. dr. Agron Xhagolli kumtesën me temë: *Martaneshi – ngjarjet dhe kënga historike*; dr. Spiro Gjoni kumtesën me temë: *Zhvillimi i arsimit në Martanesh në vitet 1970-1980*; ma. Arjeta Cuka kumtesën me temë: *E folura dhe toponimia e Martaneshit*.

Kumtesën e përgatitur nga ing. Gole Vosha me temë: *Minierat e Kromit në Martanesh në 5- vite të prodhimit të tyre – kontribut i madh në ekonominë kombëtare*, e lexoi ing. Shaban Zhaboli.

Në vazhdim ing. Tahir Osmani referoi kumtesën me temë: *Ndërtim-miniera – frymëmarrje dhe rritje e kapaciteteve nxjerrëse për minierën dhe hapje e perspektivës në thellësi e gjerësi për gjeologjinë.*

Drejtuesi i seancës prof. dr. Muharrem Dezhgiu falënderoi dhe dy kumtuesit e tjerë ing. Shadan Stërmasi për kumtesën me temë: *Gjeologjia - faktor bazë në zhvillimin industrial e ekonomik të Martaneshit* dhe dr. Qemal Lenën për kumtesën: *Martaneshi dhe perspektiva e të dhënave gjeologjike*, të cilat nuk u lexuan por që do të përfshihen në botimin e materialeve të Konferencës.

Akademik Beqir Meta, zëvendësdrejtor i Qendrës së Studimeve Albanologjike dhe drejtor i Institutit të Historisë bëri mbylljen e punimeve të kësaj konference duke vlerësuar të gjitha kumtesat e mbajtura, sidomos të rinjtë dhe duke falënderuar të gjithë pjesëmarrësit për kontributin e dhënë në studimin e vlerave e të traditave kulturore e historike të trevës së Martaneshit si trevë me ndikim të fuqishëm në vlera tona kombëtare.

Teki KURTI

